



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2484, datë 15.05. 2014

Për

**“Miratimin e Rregullave mbi regjistrimin per përdorimin e frekuencave të brezit
2.4 / 5.8 GHz”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 15.05. 2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e Rregullave mbi regjistrimin per përdorimin e frekuencave të brezit 2.4 / 5.8 GHz.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 127, 128 i Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Germa p) të nenit 8, pika 5 e nenit 65, pika 2 e nenit 67 e në vijim të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”);.
3. Plani Kombëtar i Frekuencave, miratuar me VKM nr. 466, date 27.2.2013 “Per miratimin e Planit Kombetar te Frekuencave” (PKF).

4. Rregullore "Per kushtet e perdorimit te frekuencave pa autorizim individual dhe kerkesat teknike per pajisjet radio qe perdoren ne keto breza" miratuar me VKD Nr.2481 date 15.05.2014.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor te grupit te punes si me poshte:

1. Relacioni shpjegues mbi "Miratimin e Rregullave mbi regjistrimin per perdorimin e frekuencave të brezit 2.4 / 5.8 GHz".
2. Projekt akti i paraqitur për miratim: "Rregullat mbi regjistrimin per perdorimin e frekuencave të brezit 2.4 / 5.8 GHz",
3. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumenti "Rregullat mbi regjistrimin per perdorimin e frekuencave të brezit 2.4 / 5.8 GHz" është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.
2. Hartimi i dokumentit është bazuar në mbështetje të shkronjës ë) shkronjës f) dhe shkronjes p) të nenit 8, pika 5 e nenit 65, pika 2 e nenit 67 e në vijim, pikës 3 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" (ligji nr. 9918), i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave", dhe Rregullores "Per kushtet e perdorimit te frekuencave pa autorizim individual dhe kerkesat teknike per pajisjet radio qe perdoren ne keto breza" miratuar me VKD Nr.2481 date 15.05.2014.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

1. Germen p) të nenit 8, pika 5 e nenit 65, pika 2 e nenit 67 e në vijim të ligjit 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" (ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë");.
2. Planin Kombëtar i Frekuencave, miratuar me VKM nr. 466, date 27.2.2013 "Per miratimin e Planit Kombetar te Frekuencave" (PKF).

3. Rregulloren "Per kushtet e perdorimit te frekuencave pa autorizim individual dhe kerkesat teknike per pajisjet radio qe perdoren ne keto breza" miratuar me VKD Nr.2481 date 15.05.2014.

V E N D O S :

1. Të miratojë dokumentin: *"Rregullat mbi regjistrimin per përdorimin e frekuencave të brezit 2.4/5.8 GHz", sipas lidhjes bashkengjitur.*
1. Ky vendim te publikohet ne faqen e internetit www.akep.al
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI _____
2. Alketa MUKAVELATI _____
3. Benon PALOKA _____
4. Zamira NURÇE _____